



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

## **SHPALLJE PËR REKRUTIM EKSPERTËSH TË JASHTËM**

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 57 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm (inxhinier) i cili do të llogarisë Fondin Limit, të jetë në Njësinë e Prokurimit për objektin e prokurimit: "Mbikqyrje Punimesh për Rikonstrukcion i godinës me emërtimin Atelier për dekorin e Radio-Televizionit të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe përshtatje për zyrat e AMA-s".

### **TERMAT E REFERENCES**

#### **Objektivi**

Llogaritja e Fondit Limit, hartimi i dokumentave të tenderit, ndjekja e procedurës së prokurimit deri në lidhje të kontratës me objekt "Mbikqyrje Punimesh për Rikonstrukcion i godinës me emërtimin Atelier për dekorin e Radio-Televizionit të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe përshtatje për zyrat e AMA-s".

#### **Detyrat**

Eksperti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

-Me kërkesë të AMA-s do të angazhohet në Llogaritjen e Fondit Limit, hartimin e dokumentacionit të nevojshëm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 (i ndryshuar) "Për prokurimin publik" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik";

#### **Periudha e zbatimit të detyrave:**

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë deri në lidhje të kontratës me objekt "Mbikqyrje Punimesh për Rikonstrukcion i godinës me emërtimin Atelier për dekorin e Radio-Televizionit të kaluar në përgjegjësi administrimi tek Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe përshtatje për zyrat e AMA-s".

#### **Kualifikimet dhe aftësitë e ekspertit në Njësinë e Prokurimit:**

- Diplomë e integruar ose licensë profesionale në Inxhinieri Ndërtimi;



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Eksperienca të mëparshme në formulim të detyrave të ngjashme.

**Produktet dhe materialet**

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe të gjitha propozimet, rekomandimet, dokumentet e hartuara në AMA.

**APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 13 SHTATOR 2016, ORA 10:00.**

**Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive.**

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë

